



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep. <u>Z.0-1/DPK</u>	Br. Prot. <u>04-277/15</u>
Dep.	Prot No.
Nr. I faq.	Data
Broj stranica <u>2x2</u>	Datum <u>15.09.2015</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.09.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-02-1715-15 për z.Selim Rrustemi – Anëtar i Kuvendit Komunal të Vushtrrisë, për shkak se është parandaluar konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik, meqë z.Rrustemi ka dhënë dorëheqje nga pozita e Drejtorit të SHFMU “Andon Zako Çajupi” në Vushtri.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-02-1715-15, për Zyrtarin e lartë, z. Selim Rrustemi – Këshilltar Komunal në Komunën e Vushtrrisë dhe njëkohësisht Drejtor i SHFMU “Andon Zako Çajupi” në Vushtri, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z.Rrustemi fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit (AKK), pas të cilës ai ka kërkuar takim me zyrtarët e Agjencisë kundër Korrupsionit (Dpk-Dpki-03-02/1715/15), me ç’rast aty është njoftuar me situatën e konfliktit të interesit në të cilën gjendet duke i ushtruar njëkohësisht këto dy funksione, që me Ligjin për Vetëqeverisjen lokale (Nr.03/L-040) është e ndaluar. Neni 65.2, shprehimisht thotë:

”Drejtorët komunal, drejtorët e institucioneve dhe ndërmarrjeve nën autoritetin e komunës dhe nëpunësit civil të administratës së komunës nuk mund të jenë anëtar të Kuvendit të republikës apo Kuvendit të Komunës ku ata punojnë”.

Z. Rrustemi tha se për këtë ka kërkuar sqarim edhe nga kompetentet në Komunën e Vushtrrisë mirëpo asnjë herë nuk i është thënë se paraqet konflikt interesi. Por, meqenëse tani është i bindur

për këtë, atëherë në afat sa më të shkurtë të mundshëm do të heq dore nga ushtrimi i funksionit të drejtorit në shkollën "A.Z.Çajupi".

Meqenëse Agjencia kundër Korrupsionit brenda afatit të lejuar nuk ka marr asnjë shkresë njoftuese për këtë ndryshim të premtuar nga z.Rrustemi, me datën 09.09.2015, AKK i ka dërguar edhe shkresën e dytë (Paralajmëruese) pas të cilës z.Rrustemi në Agjenci ka sjellë shkresën zyrtare Njoftim për dorëheqje nga pozita e drejtorit të shkollës (Nr.264,dt.10.09.2015), si dhe shkresën; "Aprovim" nga Komuna e Vushtrrisë, në të cilën thuhet se Drejtoria Komunale e Arsimit në mbledhjen e vet të mbajtur ka shqyrtuar dhe ka aprovuar kërkesën për dorëheqje të Drejtorit të SHFMU "Andon Zako Çajupi" në Vushtrri (DPK/DPKI-03-02-2721/15).

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

